

## GJYKATA E APELIT

**Numri i lëndës:       PAKR 434/13**

**Data:                   20 mars 2014**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Annemarie Meister si kryesuese e kolegjit, gjyqtari raportues i EULEX-it Bertil Ahnborg si dhe gjyqtari Driton Muharremi anëtarë kolegji, me pjesëmarrjen e Anna Malmström, zyrtar ligjore e EULEX-it, në cilësinë e procesverbalmbajtëses, në procedurën penale kundër të akuzuarit:

**N.B.**, me pseudonimet                   dhe                   , i lindur më XX                   19XX në                   , komuna e                   , i biri i I dhe N shtetas i Kosovës, me numrin e lejes së njoftimit XXXXXXXXXXXX, i martuar, ka tre fëmijë;

*i akuzuar sipas aktakuzës PPS 460/09 të paraqitur më 26 prill 2013 dhe i shpallur fajtor nga Gjykata Themelore të Prishtinës më 13 korrik 2013, lënda nr. PAKR 276/13, për këto vepra penale:*

**Vrasje e rëndë**, në bazë të nenit 30 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK), në lidhje me nenin 22 të Kodit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), tani e penalizuar sipas neneve 31 dhe 179 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Kodit penal të Kosovës (KPK) ;

**duke vepruar sipas ankesës së avokatit mbrojtës Osman Havolli të paraqitur në emër të N.B më 22 tetor 2013 kundër aktgjykimit të atakuar;**

*pasi shqyrtoi përgjigjen e prokurorit të apelit të Kosovës nr. APP/I 393/13 të bërë dhe të paraqitur më datën 14 nëntor 2013;*

*pasi mbajti seansë të mbyllur për publikun më 20 mars 2014 në prani të të akuzuarit **N.B** dhe avokatit mbrojtës Osman Havolli i asistuar nga Sarandë Beqiri dhe Ylber Havolli, si dhe të prokurorit të Shtetit Claudio Pala dhe palës sëdëmtuar **A.K**;*

*pas pleqërimit dhe votimit më 20 mars 2014*

duke u mbështetur në nenet 391, 394, 398 dhe 401 të Kodit të procedurës penale, Ligji nr . 04/L-123 (KPP);

lëshon këtë

---

## AKTGJYKIM

---

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa e avokatit mbrojtës Osman Havolli në emër të N.B.
  
- II. **Vërtetohet këtu aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës në rastin nr. PKR 273/13 i datës 19 korrik 2013.**

## ARSYETIM

### I. Historia procedurale e rastit

1. Aktakuza në këtë rast, PPS 460/09, është paraqitur më 26 prill 2013 në të cilën N.B është akuzuar për veprën penale të përmendur më lart. Seanca fillestare në të cilën N.B ka pranuar fajësinë u mbajt më 3 korrik 2013. Më 15 korrik 2013 është mbajtur shqyrtimi kryesor para një trupi gjykues të Gjykatës Themelore të Prishtinës i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar, për të vendosur për çështjet relevante të dënimit. Më 19 korrik 2013, është bërë shpallja e aktgjykimit me të cilin N.B u shpall fajtor për veprën penale të përmendur.

2. Më 22 tetor 2013, avokati mbrojtës Osman Havolli ka parashtruar ankesë me kohë në emër të N.B përkitazi me dënimin. Nuk ka pasur përgjigje në ankesë nga ana e prokurorit special. Mendimi i prokurorit të apelit është paraqitur më 14 nëntor 2013.

### II . Parashtrësit e palëve

#### 1. Ankesa e N.B

3. Avokati mbrojtës Osman Havolli në emër të N.B ka kundërshtuar aktgjykimin e atakuar për shkak të vendimit mbi dënimin sipas nenit 387 të KPP-së duke i propozuar Gjykatës së Apelit që të shqiptojë një dënim më të butë, duke ia llogaritur N.B në dënim kohën të cilën ai e ka kaluar nën mbrojtje të përafërt.

4. Mbrojtja parashtron se po t'i kishte vlerësuar, analizuar dhe thjeshtësuar më mirë rrethanat lehtësuese, trupi gjykues do të kishte lëshuar një vendim më të favorshëm. Për shkak të rrezikut

serioz se **N.B** do të mund të likuidohej ose sulmohej, janë ndërmarrë masa që ai të ketë siguri. Gjykata dhe Prokuroria kanë gjetur zgjidhje për të dalë nga kjo situatë e komplikuar duke arritur marrëveshje në mes të institucioneve të EULEX-it dhe **N.B** për mbrojtjen të përafërt. Mbrojtja e përafërt ishte e organizuar dhe e koordinuar mirë. Shtëpia e **N.B** ishte e mbrojtur dhe e siguruar në mënyrë të ashtuquajtur hekuri, ndërsa qasje në shtëpi kishin vetëm anëtarët e familjes me disa përjashtime. **N.B** dhe shtëpia e tij ishin sulmuar disa herë në mënyra të ndryshme dhe rrethi i sigurisë kishte filluar të ngushtohej. Ai ishte nën mbikqyrje 24 orë në ditë. Këto masa sigurie të ndërmarra për t'ia siguruar jetën atij tejkalonin kufijtë e masave dhe kriteret e sigurisë për mbrojtje të përafërt.

5. Edhe pse nuk parashihet me ligj që mbrojtja e përafërt duhet llogaritur si dënim i shqiptuar, megjithatë, nëse analizojmë dhe me kujdes vlerësojmë rastin, përgjigjen që kemi është se koha e kaluar nën mbrojtje të përafërt për gati katër vjet duhet llogaritur si heqje nga liria meqë ai ishte në izolim të plotë.

## **2. Përgjigja e prokurori të apelit**

6. Prokurori i apelit i propozon Gjykatës së Apelit që ta refuzojë ankesën si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e atakuar. Ai argumenton se sipas nenit 365 KPP përfshirja në dënim e kohës gjatë së cilës një person privohet nga liria parashihet vetëm për personin e dënuar dhe për atë heqje lirie të cilën personi e vuan kur është fjala për veprën ose veprat penale për të cilat është shpallur fajtor ose në lidhje me ndonjë dënim të mëhershëm por aty nuk përfshihen masat e sigurisë. Për më tepër, **N.B** ka qenë nën masa të mbrojtjes së përafërt në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues që kanë të bëjnë me procedurat e ndryshme penale të njohura si B1 dhe B2.

## **III. Konstatimet e Gjykatës së Apelit**

### **1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit**

7. Gjykata e Apelit është gjykata kompetente që të vendosë mbi këtë ankesë duke u bazuar në nenin 17 dhe nenin 18 të Ligjit mbi Gjykatat (Ligji nr . 03/L-199).

8. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi Gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr 03 / L - 053).

## 2. Konstatimet mbi çështjet meritore

9. **N.B** është shpallur fajtor për vrasje të rëndë në bashkëkryerje në bazë të nenit 30 paragrafi 1 dhe 2 të LPKSAK-së, në lidhje me nenin 22 të KPRSFJ-së, aktualisht e penalizuar me nenet 31 dhe 179 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 KPK-së. Çështja e fajësisë së **N.B** nuk i nënshtrohet asnjë ankese dhe për këtë arsye nuk bie në kuadër të rishqyrtimit të Gjykatës së Apelit. Subjekt i ankesës është vetëm vendimi mbi dënimin.

10. Bazuar në parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm, neni 3 i KPK-së (neni 4 paragrafi 2 KPRSFJ), gjykata duhet së pari të vendosë se cili ligj është më i favorshëm për të pandehurin në rastin aktual. Kjo çështje është analizuar dhe arsyetuar në thellësi në aktgjykimin e atakuar. Gjykata e Apelit pajtohet me konstatimet e Gjykatës Themelore që ligj më i favorshëm si dhe i aplikueshëm është Ligji penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK) me një dënim minimal prej dhjetë (10) vjet burgim dhe një dënim maksimal prej pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim për vrasje të rëndë. Në bazë të nenit 42 paragrafi 2 të KPRSFJ-së, gjykata mund të vendosë dënim nën kufirin e përcaktuar me ligj dhe se në zbatim të nenit 43 paragrafi 1 pika 1.1 të KPRSFJ-së, nëse periudha prej tre ose më shumë vjet burgim parashihet si kufiri më i ulët i dënimit, ai mundet të zvogëlohet për një periudhë deri në një vit burgim.

11. Gjatë vendosjes mbi dënimin, Gjykata Themelore ka analizuar përsëri në thellësi faktorët që kanë rëndësi, rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Si rrethanë lehtësuese Gjykata Themelore ka marrë parasysh sjelljen e të pandehurit dhe gjendjen e tij familjare. **N.B** është i martuar dhe ka tre fëmijë të moshës 8, 10 dhe 12 vjeç. Ai vullnetarisht është paraqitur për të folur lidhur me veprën penale në këtë rast si dhe lidhur me një numër veprash të tjera penale në të cilat ai kishte qenë i përfshirë dhe kishte njohuri për to. Ai ka pranuar se e ka kryer vrasjen në këtë rast dhe e ka pranuar fajësinë. Që nga momenti i paraqitjes së tij ai e ka pritur dënimin e tij dhe ka e konfirmuar në mënyrë të përsëritur versionin e tij fillestar të fakteve. Që nga viti 2010 ai ka qenë nën mbrojtje të përafërt për shkak të vendimit të tij për të dalë në shesh dhe dëshmuar kundër bashkë-autorëve të krimit.

12. Si faktorë rëndues Gjykata Themelore ka marrë parasysh vetëm rrethanat e krimit që patën si rrjedhojë që vepra penale të kualifikohet si vrasje e rëndë. Këto rrethana me të drejtë nuk u morën më parasysh gjatë shqiptimit të dënimit.

13. Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata Themelore i ka identifikuar në mënyrë korrekte rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe ato gjithashtu janë marrë parasysh edhe nga Gjykata e Apelit. Gjykata e Apelit më tej konstaton se dënimi i shqiptuar është i arsyeshëm dhe proporcional. Gjykata e Apelit ka marrë veçanërisht parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga **N.B** dhe vendimin e tij për t'u paraqitur haptazi. Gjykata e Apelit në veçanti ka marrë parasysh faktin se që nga momenti që ai është paraqitur haptazi, **N.B** dhe familja e tij kanë qenë nën kërcënim të vazhdueshëm dhe ndoshta do të vazhdojnë të jenë në gjendje të tillë për një kohë të gjatë nëse jo edhe gjatë gjithë jetës së tyre. Që nga viti 2010 ata kanë jetuar me

mbrojtje të përafërt e cila ua ka kufizuar rreptësisht lirinë. Gjykata e Apelit megjithatë është e vetëdijshme dhe ka në mendje se **N.B** është fajtor për një veprë shumë të rëndë penale.

14. Koha të cilën **N.B** e ka kaluar në arrest shtëpiak i është llogaritur atij si duhet në dënim në bazë të nenit 365 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të KKP-së. **N.B** në ankesën e tij ka paraqitur si argument se edhe koha e kaluar me mbrojtje të përafërt duhet të llogaritet në dënim. Llogaritja e kohës së shpenzuar gjatë heqjes së lirisë rregullohet me nenin 50 të KPRSFJ-së (neni 83 KPK). Ai nen thotë:

*“Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë.”*

**N.B** ka paraqitur si argument se forma e mbrojtjes të cilën ai e ka pasur gjatë viteve të fundit, edhe pse nuk parashihet si e tillë në ligj, ka qenë heqje lirie.

15. Gjykata e Apelit nuk mund të gjejë bazë ligjore që t’ia llogarisë në dënim kohën të cilën **N.B** e ka kaluar me mbrojtjen e përafërt. Ligji e parasheh që koha e kaluar gjatë heqjes së lirisë për një veprë penale të llogaritet në dënim. Kjo vlen për çdo formë paraburgimit që shqiptohet për shkak të veprës penale, pa marrë parasysh se cili autoritet e ka shqiptuar<sup>1</sup>. Çështje kyçe është, konstaton Gjykata e Apelit, që te ketë urdhër për heqje të lirisë dhe se ajo heqje lirie të jetë e urdhëruar për shkak të një veprë penale e cila është kryer.

16. Gjykata e Apelit asesi nuk dyshon se ajo kohë për **N.B** ka qenë me të vërtetë heqje lirie në kuptimin e asaj se ai nuk ka qenë në gjendje të lëvizë lirisht. Kjo megjithatë nuk është heqje lirie në mënyrën si e sheh ligji sepse atë nuk e ka shqiptuar asnjë gjykatë apo autoritet tjetër. Mbrojtja e përafërt i është siguruar **N.B** për shkak të kërcënimit të vazhdueshëm ndaj jetës së tij për arsye të vendimit të tij për t’u paraqitur haptazi me tregimin dhe dëshmitë që ai kishte kundër një numri njerëzish. Mbrojtja megjithatë i është siguruar atij gjatë gjithë kohës me pëlqimin e **N.B**. Meqë masa e arrestit shtëpiak kundër tij u hoq në tetor 2010 deri sa nuk iu shqiptua përsëri në korrik 2013 ai ka qenë në gjendje që në çdo kohë të refuzojë mbrojtjen. Mbrojtja nuk i është siguruar atij për shkak të veprës penale për të cilën ai është shpallur fajtor në këtë rast. Ajo i është siguruar me arsyetimin se **N.B** është dëshmitar bashkëpunues në dy raste të tjera penale.

17. Në përfundim, Gjykata e Apelit konstaton se koha të cilën **N.B** e ka kaluar në mbrojtje të përafërt nuk mund t’i llogaritet në dënim në mënyrë ligjshme. Ajo megjithatë është marrë parasysh si rrethanë lehtësuese si nga Gjykata Themelore poashtu edhe nga Gjykata e Apelit duke pasur si rrjedhojë zbutjen e dënimit.

---

<sup>1</sup> Shih Komentarin e Kodit penal të RSFJ-së 1982, neni 50.

Gjyqtar kryesues

---

Annamarie Meister

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtar kolegji

Anëtar kolegji

Procesverbalmajtëse

---

Bertil Ahnborg

---

Driton Muharrem

---

Anna Malmström

Gjyqtar i EULEX-it

Gjyqtar

Zyrtar ligjore e EULEX-it

Përgatitur në anglisht, gjuhë kjo e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar i përfunduar dhe i nënshkruar më 26 mars të vitit 2014.